



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E DRAGASHIT
THE MUNICIPALITY DRAGASH
OPŠTINA DRAGAŠ



DREJTORIA PËR ARSIMIT

NR.13/ 486

Datë : 02.07.2025

Bazuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr.04/L-032, Ligjin për Arsimi dhe aftësim profesional nr. 04L-138 dhe bazuar në kushtet dhe kriteret e regjistrim të nxënësve në klasën e dhjetë (10) në gjimnaze dhe institucionet e Arsimit dhe Aftësimit Profesional (IAAP), të caktuara nga MASHT, Drejtoria komunale e Arsimit shpall

KONKURS

PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E DHJETË (10) TË GJIMNAZEVE DHE TË SHKOLLAVE PROFESIONALE PËR VITIN SHKOLLOR 2025/2026

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, të gjimnazeve dhe të shkollave profesionale, për vitin shkollor 2025/26, mund të konkurrojnë kandidatët, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.

Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9-të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaze dhe shkolla profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente:

- **Fletëparaqitjen** (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)
- **Dëftesën** origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe
- **Certifikatën e lindjes.**

3. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për gjimnaze dhe shkolla profesionale për vitin shkollor 2025/2026, bëhet më datën : **08, 09, 10 KORRIK 2025**, në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora: 8:00 -16:00.

- Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollat përkatëse me datën: **11.07.2025**

Nxënësi i pakënaqur me rezultatin e publikuar, ka të drejtë ankese brenda (2) ditë pune, nga koha e shpalljes së rezultateve. Ankesa parashtrohet në drejtorinë e shkollës, Ankesat në shkollën e dytë bëhen në Drejtorinë Komunale të Arsimit brenda (2) ditë pune, pas pranimit të përgjigjes nga shkolla.

A. Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kritere:

- | | | |
|--|-------|---------|
| 1. Suksesi nga shkollimi i | (40%) | 40 pikë |
| 2. Suksesi nga lëndët prioritare në test | (20%) | 20 pikë |
| 3. Numri i pikëve nga testi | (40%) | 40 pikë |

Nxënësi duhet t'i fitojë maksimalisht (100%), 100 pikë.

Gjimnazi “Ruzhdi Berisha”- Dragash (shqip)

Nr. i par.	Shkenca natyrore	Shkenca shoqerore	Nr. i nx. ne paralele
3	2	1	3 x 22
Gjithsejt 66 nxënës			

Drejtimit Profesionale

Nr. i par.	Profili	Nr.i paraleleve	Gjithsej
Ekonomi			
1	Banka dhe sigurime	1	22
1	Tregtar me shumicë dhe pakicë	1	22
Juridik			
1	Administratë dhe shërbime të zyrës	1	22
Teknologji e informacionit dhe komunikimit			
1	Teknik i sistemeve të TIK-ut	1	22
Shëndeti dhe mirëqenia			
1	Bashkëpunëtorë Profesional i Infermierisë	1	22
1	Teknik i Farmacisë	1	22
Gjithsejt 132 nxënës			
66+132=198			

Gjimnazi "Ruzhdi Berisha"- Dragash (boshnjakisht)

Nr. i par.		Shkenca shoqerore	Nr. i nx. ne paralele
1		1	22
	Gjithsejt	22	nxënës

Drejtimitet Profesionale (boshnjakisht)

Nr. i par.	Profili	Nr.i paraleleve	Gjithsej
1	Juridik		
	Administratë dhe shërbime të zyrës	1	22
2	Shëndeti dhe mirëqenia		
	Bashkëpunëtorë Profesional i Infermierisë	1	22
	Gjithsej nxënës		
	22+44=66		

Gjithsej nxënës në nivel shkolle për vitin shkollor 2025/2026

$$\underline{198 + 66 = 264}$$

Drejtori i DKA-së
Zeni Krasniqi

